



KOMISIONI SHTETËROR I RINDËRTIMIT

V E N D I M

Nr. 53 datë 10.10.2020

Në mbështetje të Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit nr.878, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, organizimin e veprimtarive dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit”, Komisioni Shtetëror i Rindërtimit.

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën për financim të Bashkisë Durrës, për Programin e Granteve të Rindërtimitin “*Grante Rikonstruksioni*”, për listën e objekteve, banesave individuale dhe njësi banimi në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë që rezultojnë me shkallë dëmtueshmërie DS1-DS3 dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, sipas Akt Konstatimeve, miratuar përkatësisht me **Vendimin e Këshillit të Bashkisë Durrës nr. 100 datë 30.09.2020** përcjellë pranë Komisionit Shtetëror për Rindërtim, me shkresën nr. 12252 prot., datë 06.10.2020, në masën prej 63 250 000 (*gjashtëdhjetë e tre milion e dyqind e pesëdhjetë mijë*) lekë e detajuar si më poshtë:

Përfutjes	Numri	Klasifikimi	Vlera Totale (lekë)
	30	DS1	3 000 000
	73	DS2	18 250 000
	84	DS3	42 000 000
	187	Totali	63 250 000

2. T’i propozojë Këshillit të Ministrave përdorimin e Fondit të Rindërtimit nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore, Bashkia Durrës, në masën prej 63 250 000 (*gjashtëdhjetë e tre milion e dyqind e pesëdhjetë mijë*) lekë, sipas pikës 1 të këtij Vendimi.
3. Të miratojë kërkesën me nr. 5997 prot, datë 09.10.2020, të Bashkisë Kurbin, të përcjellë pranë Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, përkatësisht për financimin e rindërtimit në gjurmën ekzistuese të Institucionit "Bashkia Kurbin", në masën 296 969 254.28 (*dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë njëzet e tetë*) lekë.
4. Të caktojë Bashkinë Kurbin si “Njësi Zbatuese” për zbatimin e pikës 3 të këtij Vendimi.

5. T'i propozojë Këshillit të Ministrave përdorimin e Fondit të Rindërtimit miratuar në buxhetin e vitit 2020, nga Bashkia Kurbin, në masën 296 969 254.28 (*dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë njëzet e tetë*) lekë, për financimin e rindërtimit të Institucionit "Bashkia Kurbin", sipas pikës 3 dhe 4 të këtij Vendimi.
6. Të miratojë kërkesën me nr. 5998 prot, datë 09.10.2020, të Bashkisë Kurbin, të përcjellë pranë Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objektit arsimor shkolla 9-vjeçare "Gjon Gjonaj", në masën 199 602 139.60 (*njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e dy mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë*) lekë.
7. Të caktojë Bashkinë Kurbin si "Njësi Zbatuese" për zbatimin e pikës 6 të këtij Vendimi.
8. T'i propozojë Këshillit të Ministrave përdorimin e Fondit të Rindërtimit miratuar në buxhetin e vitit 2020, nga Bashkia Kurbin, në masën 199 602 139.60 (*njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e dy mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë*) lekë, për financimin e rindërtimit të objektit arsimor shkolla 9-vjeçare "Gjon Gjonaj", sipas pikës 6 dhe 7 të këtij Vendimi.
9. Të miratojë rindërtimin në të njëjtin truall, të njësive individuale të banimit, të vlerësuara "për shembje", sipas kërkesës me nr. 5736 prot., datë 30.09.2020 të Bashkisë Kurbin, për rindërtimin e 109 njesive individuale, të **Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.112, datë 30.09.2020** sipas listës bashkëlidhur këtij Vendimi, referuar akt ekspertizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit. Rindërtimi në të njëjtin truall, të njësive individuale të banimit, do të bëhet sipas projekteve model të hartuara nga Enti Kombëtar i Banesave.
10. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, së bashku me Bashkinë Kurbin pas miratimit të këtij vendimi, të fillojnë nga puna për hartimin e PDyV-ve për zonat e dëmtuara pikësore, ku njësitë individuale të banimit, janë vlerësuar për "shembje" nga Instituti i Ndërtimit dhe janë miratuar nga Këshilli Bashkiak, sipas pikës 6 të këtij Vendimi.
11. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkia Kurbin, bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMISIONIT SHTETËROR TË RINDËRTIMIT

Arben AHMETAJ

Sandër LLESHAJ

Anila DENAJ

Anëtar

Anëtar

Evis KUSHI

Elva MARGARITI

Anëtar

Anëtar

Bledar ÇUÇI

Blendi KLOSI

Anëtar

Anëtar

Olta XHAÇKA

Belinda BALLUKU

Anëtar

Anëtar

Ogerta MANASTIRLIU

Anëtar